

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborna Komisija za Žalbe i Molbe
Elections Complaints and Appeals Commission

K Z A P
I K Ž M - E C A C

A nr. 12/2009

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, në panelin e përbërë nga Osman Tmava, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Muharrem Shala, anëtarë, në seancën e mbajtur më datë 13.10.2009, mori

VENDIM

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

ARSYETIMI

Z. Lutfi Haziri, kryetar i Shtabit Zgjedhor të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës në Prishtinë, ka parashtruar ankesë me të cilën pretendon se përfaqësuesit e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e kanë shkelur Kodin e Mirësjelljes.

FAKTET

Më 7 Tetor 2009, Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP) ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) më 5 Tetor 2009, nga Z. Lutfi Haziri, duke pretenduar se përfaqësuesit e subjektit politik të AAK-së, e kanë shkelur Rregulloren e Zgjedhjeve Nr. 13/2009, për *Fushatën e Zgjedhjeve të Subjekteve Politike*, ashtu që qytetin e Prishtinës kanë vendosur billbordet e Kryetarit të tyre Z. Ramush Haradinaj dhe nën-kryetarit Z. Blerim Shala para fillimit të periudhës së fushatës zgjedhore, datë 15 Tetor 2009. Ankuesi ka bashkangjitur fotografitë që duken të jenë billbordet e fushatës së AAK-së.

ANALIZË

Jurisdiksioni i KZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

Parashtruesi i ankesës pretendon se përfaqësuesit e AAK-së, kanë shkelur Rregullën e zgjedhjeve Nr 13/2009 për *Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike* ashtu që kanë vendosur billbordet në qytetin e Prishtinës para fillimit të fushatës së zgjedhjeve, datë 15 Tetor 2009.

LZP me dispozitën e nenit 44, përcaktohen aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore në mënyrat e specifikuara me atë dispozitë ligjore.

LZP me dispozitën e nenit 33 dhe Rregullorja e Zgjedhjeve Nr 11/2009, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, me dispozitën

e nenit 4, u ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatëve të tyre, të caktuara me këto dispozita ligjore gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Meqenëse veprimet e pretenduara nuk janë bërë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, vlerësohet në pajtim me dispozitat e cituara ligjore se nuk kemi të bëjmë me veprime të ndaluara, për çka edhe vlerësohet se ankesa është e pabazuar.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësë në Prishtinë

A nr. 12/2009 më datën 13.10.2009.

Kryesuesi/ Panelit

~~Osman Tmava~~

